

**AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
HANXHARI 1 SH.P.K**

EMERTIMI, OBJEKTI I VEPRIMTARISE, SELIA E SHOQERISE, KOHEZGJATJA.

Ne baze te Ligjit nr.7512, date 10.08.1991, dhe ndryshimeve "Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private, te nismes se lire, te veprimtarise private te pavarur dhe privatizimit" dhe ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" dhe statutit te shoqerise, me vullnetin e tij te lire shprehur ne nenskrimin e ketij akti, ortaket :

Zoti Fatmir Hanxhari , lindur ne Vlore, date 19.12.1951 , me Karte Identiteti Nr F11219025C , me Shtetesi dhe Kombesi shqiptare ,

Zonja Vasilika Hanxhari , lindur ne Selenice -Vlore, date 17.05.1959 , me Karte Identiteti Nr F95517065W, me Shtetesi dhe Kombesi shqiptare ,

Zonja Linda Hanxhari , lindur ne Vlore, date 04.05.1997 , me Karte Identiteti Nr J75504087M, me Shtetesi dhe Kombesi shqiptare

kane hartuar, si me poshte vijon:

Aktin e Themelimit e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar.

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 "**Per tregtaret dhe shoqerite tregtare**", te Ligjit Nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise, si dhe dispozitat e Statutit te shoqerise qe i bashkengjiten ketij Akti Themelimi.

EMERTIMI I SHOQERISE eshte HANXHARI 1 SH.P.K

SELIA E SHOQERISE.

Vlore, Bulevardi Ismail Qemali, Lagja Pavaresia, Nr pasurise 27/78-ND, kati i dyte.

Ajo mund te transferohet ne cdo vend tjeter te rrethit, ose mund te transferohet kudo ne territorin e Republikes se Shqiperise, ne baze te nje vendimi te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te ortakeve. Ajo me vendim te asamblese se ortakeve mund te hap dhe mbyll filiale, dege ose zyra perfaqesimi ne te gjithë teritorin e Republikes se Shqiperise.

JETEGJATESIA E SHOQERISE

Kohezgjatja e shoqerise eshte caktuar pesedhjet vjet (50) duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tragtar. Shkurtimi I kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te pershpejtuar ose zgjatja e afatit behen me vendim te asamblese se pergjithshme te jashtezakonshme te ortakeve.

OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria ka per objekt:

Aktivitet ne fushen e ndertimit, hoteleri, restorante, barkafe, agjensi turistike, menaxhim turizmi,etj. Ndertime civile industriale-turistike-bujqesore, ndertime rrugore, ura dhe vepra arti, vepra te vecanta e punime speciale, punime karpentierie, lidhje hekuri, punime sherbimi mekanike, hidraulike, elektrike, sherbime e punime ne lidhje me sektorin e ndertimit.

Aktivitet ne fushen e menaxhimit te pasurive te paluajtshme, shitje, blerje, dhenie me qera,reklamim etj.

Aktivitet ne fushen e transportit. Kryerja e transportit per llogari te vet dhe /ose te te treteve,transport i mallrave kombetare dhe nderkombetare.

Import-Eksport.Tregti me shumice dhe pakice te mallrave te ndryshem industrial ushqimore dhe karburante.

Këmbim valutor, agjent për transferimin e parave, me dhe per llogari te subjektit financiar jo banke.

Shoqeria mund te kryeje cfaredo lloj sherbimi qe paraqitet ne pajtueshmeri me objektin e saj dhe qe eshte lidhur me kete objekt, duke perjashtuar ato sherbime apo veprimtari qe do te shkaktonin devijimin e saj nga karakteri plotesisht i percaktuar me ligje te vecanta.

KAPITALI I SHOQERISE

Kapitali aksionar i nenshkruar eshte caktuar ne vlere prej 100.000 (njqind mije) leke , i ndare ne 3 (tri) kuota dhe zoterohet nga ortaket:

Z.Fatmir Hanxhari, 1(nje)kuote, me pjesëmarrja në përqindje (%) 40%, me vlere nominale 40.000 (dyzetemije) leke.

Znj.Vasilika Hanxhari, 1(nje)kuote, me pjesëmarrja në përqindje (%) 30%, me vlere nominale 30.000 (tridhjetemije) leke.

Znj.Linda Hanxhari, 1(nje)kuote, me pjesëmarrja në përqindje (%) 30%, me vlere nominale 30.000 (tridhjetemije) leke.

Kontributi (kapitali aksionar) i ortakut eshte ne para (leke).

Ortaket i ardhshem ka derdhur shumen koresponduese te pjeseve te nenshkruara.

Personi qe firmos kete akt, pasi ka mare dijeni per kete certificate, nje kopje ekzakte e se ciles i eshte paraqitur atij, deklaron se shuma e mesiperme eshte ne perputhje me ate qe shenohet ne certificate dhe se ato konfirmojne nenshkrimet e pjeseve te kapitalit aksionar ne perputhje me shumen respektive te derdhur.

ORGANET E SHOQERISE

Organet e shoqerise jane:

- Asambleja e Ortakeve.
- Administratori.

Asambleja e Ortakeve eshte ogani me i larte i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

HANXHARI 1 SH.P.K

Nepermjet ketij emerohet administratori i shoqerise **Zoti Fatmir Hanxhari**, te cilit I jepen te gjitha kompetencat, qe ai i pranon, per te kryer te gjitha formalitetet per krijimin e shoqerise, parashikuar sipas ligjit ne fuqi.

Ortaket dhe administratori ushtrojne te gjitha kompetencat, te drejtat dhe detyrimet per organizimin dhe drejtimin e shoqerise, te cilat parashikohen nga ky statut, akti i themelimit dhe legjislacioni shqiptar, per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise, ne perputhje me objektin e veprimtarise se saj, me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht ortakeve.

Kompetencat e administratorit jane:

- Organizimi i veprimtarise se shoqerise per te plotesuar programin qe buron nga objekti i veprimtarise se saj.
- Administrimi i pergjithshem i shoqerise.
- Perfaqeson shoqerine para autoriteteve gjyqesore, te arbitrimet dhe administrative.
- Administron pasurine dhe aktivet financiare te shoqerise, brenda kufijeve te caktuar nga ortaket.
- Te leshoje dokumente zyrtare ne emer te shoqerise per te punesuarit e shoqerise dhe ne pergjithesi per palet e treta.
- Ne rast emerimi te dy administratoreve, administratoret kane te drejte te ushtrojne kompetencat e tyre te plota ne menyre te pavarur.

Ushtrimi financiar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtimisht viti I pare financiar kur do te nise veprimtaria e shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor.

Shoqeria e fillon aktivitetin ne momentin e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit Tirane.

Marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me ane te kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen me kontraten e punes, zbatohen dispozitat e Kodit te Punes.

Ky akt-themelimi eshte hartuar ne VLORE , me 03.08.2023, ne kater ekzemplare duke patur te gjithë tekstet ne fuqi te barabarte.

FIRMOSUR NGA ORTAKET

(Fatmir Hanxhari)

Fatmir Hanxhari
[Signature]

(Vasilika Hanxhari)

Vasilika Hanxhari
[Signature]

(Linda Hanxhari)

Linda Hanxhari
[Signature]